



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq-Skupština Opštine Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.23.05.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Sami Ahmeti, Ajshe Haliti Pllana dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nëkryetar i Komunës, drejtorët komunal dhe Drita Hashani, zyrtare ligjore

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Rregullore për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Obiliqit
4. Shqyrtimi i Marrëveshje zotimi në mes të Komunës së Obiliqit dhe Postës
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 5 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Labinot Mirena me arsye

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 3 vota për dhe 2 vota kundër.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju materialin e keni marrë dhe e dini se kjo Draft Rregullore ka qenë në debat publik. Tani, nëse nuk keni diçka për të thënë dhe jeni dakord duhet ta rekomandojmë për Kuvend.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo Draft Rregullore ti rekomandohet Kuvendit.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që kjo Rregullore të shkoj për Kuvend.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Obiliqit.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Po ashtu, ju e keni pranuar edhe Marrëveshje zotimi në mes të Komunës së Obiliqit dhe Postës dhe nëse, nuk keni diçka për të thënë e rekomandojmë për Kuvend.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që të rekomandohet kjo marrëveshje për Kuvend.

Sami Ahmeti – Realisht për dislokimin e postës jemi dakord, por jo ku është paraparë. Ne jemi kundër.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 3 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshje zotimit në mes të Komunës së Obiliqit dhe Postës.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën nga Kimete Rama, për kthimin e pronës në rr.”Faruk Begolli” nga emri Mihane Rama në emrin e Kimete Ramës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan DPUKP-së, shqyrtimin e kërkesës nr.-I-11537, të dt.06.05.2022 dhe në Kuvend të vjen me rekomandim.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht ia rekomanduan DPUKP-së, për shqyrtim kërkesën nr.-I-11537, të dt.06.05.2022 dhe në Kuvend të vjen me rekomandim.

Kryesuesja - Paraqet kërkesën nga Sami Saraqi, Kryetar i shoqatës së invalidëve të luftës së UÇK-së, për përkrahje për një ekskurzion.

Abdyrrahman Krasniqi – Besoj se ne kemi mjete për realizimin e kësaj kërkesë dhe propozoj që kjo kërkesë ti rekomandohet Kuvendit komunal.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo kërkesë ti rekomandohet Kuvendit komunal.

Sami Ahmeti – Drejtoria përkatëse është mirë që të vjen me rekomandim.

Enver Gashi – Në momentin që ne një kërkesë e dërgojmë për shqyrtim në Drejtorinë përkatëse, Drejtoria vjen me rekomandim në mbledhjen e Kuvendit komunal. Pastaj, ne mund të diskutojmë për kërkesën në fjalë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht ia rekomanduan Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim kërkesën nr.-I-12851, të dt.17.05.2022 dhe DSHPE-ja, të vjen me rekomandim.

Abdyrrahman Krasniqi – Mjetet mund të ndahen vetëm nga kategoria e subvencioneve.

Mbledhja përfundoi në ora 10:13’

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesja e KPF


Vlora Mjekiqi Kabashi